



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KUKËS

Nr. 1031 Prot.

Kukës, më 17.08.2026

NJOFTIM
PËR PRANIMIN E KËRKESAVE TË PUNËS PRANË ZVAP KUKËS
PËR VITIN SHKOLLOR 2026 - 2027.

Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012, *Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024, *Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë"*, udhëzimit nr. 19, datë 29.08.2024, *Për disa ndryshime dhe shtesa të Udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024*, udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2026, *Për disa ndryshime dhe shtesa të udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024*, **ZVAP Kukës** njofton se mund të dorëzojnë dosjet me dokumentacionin përkatës të gjithë kandidatët e interesuar për t'u punësuar pranë IAP-ve të ZVAP Kukës dhe që nuk janë pjesë e portalit "Mësues për Shqipërinë".

Dokumentet që duhet të përmbajë dosja:

- Kërkesë me shkrim
- CV
- Kopje e noterizuar e diplomës/ave, vërtetimit / listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlefshme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;
- Dëshmi e gjuhës së huaj (Nëse ka)
- Kopje e noterizuar e Provimit të shtetit (Licencës),
- Librezë pune e noterizuar (Nëse ka)
- Çertifikatë trajnimesh me pikë krediti e noterizuar (Nëse ka)
- Dëshmi penaliteti
- Kopje e noterizuar e kartës së identitetit.\
- Raport mjeko-ligjor nga E-Albania

Dorëzimi i dosjeve do të bëhet nga data 18.08.2026 deri me datën 07.09.2026 vetëm me anë të shërbimit postar në adresën e ZVAP Kukes në adresën: **Lagjia nr. 5, sheshi "Muharrem Bajraktari".**

ZVAP Kukes do të marrë në shqyrtim vetëm kërkesat e profileve të mësuesisë, të ardhura brenda këtij afati të përcaktuar dhe nuk do të marrë në shqyrtim asnjë kërkesë tjetër të bërë në vitet e kaluara qoftë dhe nga ata që kanë qenë mësues të kontraktuar më parë. Pas vlerësimit të të gjitha dosjeve do të bëhet renditja e tyre sipas pikëve dhe do të kalojnë në listë pritëse.

DREJTOR

KRESHNIK GËRBOLLI

